



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
**UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"**  
**SENATI AKADEMIK**



Nr. 21/ prot.  
1/

**VENDIM**

Elbasan, më 14.01.2022

Nr. 1 datë 14.01.2022

**"PËR**

**MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR PËR VEPRIMTARIË NË  
UNIVERSITETIN E ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI" PËR VITIN  
AKADEMIK 2020-2021"**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38," Udhëzimit të MASR nr. 5, datë 19.2.2018 "Për përcaktimin e elementeve përbërëse të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë", të ndryshuar, Statuti të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", neni 9, pika 11, Senati Akademik,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë Raportin vjetor për veprimtari në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" për vitin akademik 2020-2021, bashkëlidhur vendimit.
2. Një kopje e këtij Raporti t'i përcillet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Në mungesë dhe me porosi  
**NËNKRYETARI  
I SENATIT AKADEMIK**  
**Prof. Dr. Pranvera GJOCI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
**UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"**  
**SENATI AKADEMIK**



Nr. 21/ 1 prot.

**VENDIM**

Elbasan, më 14.01.2022

Nr. 1 datë 14.01.2022

**"PËR**

**MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR PËR VEPRIMTARIË NË  
UNIVERSITETIN E ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI" PËR VITIN  
AKADEMIK 2020-2021"**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, "Udhëzimit të MASR nr. 5, datë 19.2.2018 "Për përcaktimin e elementeve përbërëse të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë", të ndryshuar, Statuti të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", neni 9, pika 11, Senati Akademik,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë Raportin vjetor për veprimtarië në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" për vitin akademik 2020-2021, bashkëlidhur vendimit.
2. Një kopje e këtij Raporti t'i përcillet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Në mungesë dhe me porosi  
NËNKRYETARI**

**I SENATIT AKADEMIK  
Prof. Dr. Pranvera GJOCI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"  
REKTORATI

**RAPORT VJETOR I VEPRIMTARISË NË UNIVERSITETIN  
E ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"  
PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021**

Adresa: Rruga "Ismael Zyra" Elbasan, Tel & fax: +355 542 52593, Web: [www.uniel.edu.al](http://www.uniel.edu.al), [info@uniel.edu.al](mailto:info@uniel.edu.al)





## A. SENATI AKADEMIK

Vepërimitarë e vet për vitin akademik 2020-2021, Universiteti i Elbasanit "Aleksander Xhuvani" e trajton sipas udhëzimit nr. 5, datë 19.2.2018 të MASR (MAS) "Për përcaktimin e elementeve përbërëse të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë".

- Viti akademik 2020-2021 ka qenë një vit pune me shumë sfida, sepse u vijua përballimi i situatës së pandemisë.
- Për vitin 2020-2021, ngarkesa e personelit akademik është realizuar 100% nëpërmjet mësimdhënies online. Për shkak të situatës së shkaktuar nga pandemia e COVID-19, bazuar në urdhrat e MAS, vendimeve të Rectoratit dhe njësisë të UJ-së, procesi mësimor për të gjitha programet e studimit, në të gjitha kurset, për këtë vit akademik është zhvilluar online në mënyrë virtuale. Mësimdhënia online është realizuar deri në përfundimin e ngarkesës, sipas planeve mësimore dhe syllabuseve përkatëse, duke përmbytur të gjitha elementët e veprimtarisë mësimore si leksionet, seminarët e lëndëve/moduleve, laboratorët dhe praktikat profesionale.
- Pavarësisht paqartësive të fillimit, personeli akademik u përshat me lehtësi ndaj kësaj forme të re të mësimdhënies, ndërkohë që edhe nga ana e studentëve ka patur një prarueshmëri të kënaqshme dhe lehtësi në përdorimin e platformës online të mësimdhënies, Microsoft Teams. Pjesëmarrja, pavarësisht vështirësive, ka qenë e kënaqshme, duke u aktivizuar 70-80% e studentëve. Studentët që nuk kanë qenë aktivë online, sipas informacioneve që kemi, kanë patur vështirësi logjistike për t'i ndjekur leksionet (mungesë shërbimi interneti, kompjuteri, celulari smart etj.). Në klasat virtuale janë bashkuar edhe studentë të mbartur, të cilët kanë parë te mësimdhënia online një mundësi për të rifreskuar dijet e tyre në lëndët që nuk janë vlerësuar pozitivisht në provime dhe për të qenë të gatshëm t'i njëjpin në sezon.
- Në platformën online Microsoft Teams, personeli akademik ka publikuar prezantimet e leksioneve në powerpoint, disa kanë publikuar edhe leksionet (të skanuara ose format word/pdf), si dhe kanë komunikuar në mënyrë interaktive me studentët. Gjithashtu disa kanë ngarkuar në sistem edhe materiale në format audio dhe video. Janë dhënë rregullisht detyra të përjavshme, janë zhvilluar teste të shkurtra, si dhe janë caktuar projekte kursi për t'u dorëzuar online. Mund të thuhet me siguri që çdo aktivitet i planifikuar më parë për t'u zhvilluar në audiorë, është përmbytur online.
- Në periudhën qershor-korrik 2021, paralelisht me zhvillimin e mësimi online, janë zhvilluar në auditor (me prezencë fizike) konsultime nga të gjithë pedagogët për përsëritjen e leksioneve dhe seminareve, duke respektuar masat mbrojtëse nga Covid-19.
- Në këtë vit akademik realizuam përmbylljen e procesit të doktorimit për 17 doktorantë të programit "Doktoratë në albanologji", profili gjuhësi dhe histori, të regjistruar në vitin akademik 2011-2012 dhe 2012-2013.
- Krahas realizimit të planeve për të gjitha programet e studimit, të niveleve diplomë profesionale, bachelor dhe master, mund të veçojmë realizimin e programit më të ri të studimit "Program i integruar i ciklit të dytë Master i Shkencave në Drejtësi".

Raportimi vjetor për vitin akademik 2020-2021, bazohet kryesisht në realizimin e misionit dhe detyrave të përcaktuara, arritjeve, vështirësive si dhe të objektivave e synimeve që ka për të





Universiteti i Elbasanit "Aleksander Xhuvani" ka disa struktura pranë Rektoratit (drejtoritë) si dhe 5 (pesë) njësi kryesore (fakultete) dhe 25 (njëzet e pesë) njësi bazë (departamente dhe qendra kërkimore):

1. Fakulteti i Shkencave të Edukimit, me 5 (pesë) njësi bazë;
2. Fakulteti i Shkencave të Natyrës, me 5 (pesë) njësi bazë;
3. Fakulteti i Shkencave Humane, me 5 (pesë) njësi bazë;
4. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, me 4 (katër) njësi bazë;
5. Fakulteti Ekonomik, me 6 (gjashtë) njësi bazë.

Gjatë vitit 2020-2021, njësitë kryesore dhe njësitë bazë, kanë përcaktuar dhe realizuar objektivat e tyre, duke e orientuar punën mësimore e shkencore në disa drejtime:

- Ristrukturimi, përmirësimi dhe hapja e programeve të studimit, për të gjitha ciklet, është synuar në vijimësi dhe në përputhje me standardet akademike dhe gjithë dokumentacionit universitar.
- Rritja cilësore është synuar për procesin mësimor, duke e shoqëruar me përditësimin dhe pasurimin e përmbajtjes së ligjëratave dhe scencave praktike me të reja bashkëkohore; si dhe zbatimin e modeleve dhe teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies.
- Realizimi në mënyrë sa më cilësore i praktikave profesionale dhe praktikave në terren të studentëve.
- Përgatitja dhe nxitja e dokumentacionit të domosdoshëm dhe matja e masave për minimizim deri në eliminim të problematikave të hasura, siguron mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe shkencor.
- Sigurimi i cilësisë së shërbimit të ofruar nga personeli dhe infrastruktura e laboratorëve; sigurimi i asistencës së nevojshme për të gjithë studentët dhe sidomos për mbarëvajtjen e tyre në lidhje me tregun e punës dhe kualifikimin e mtejshëm të tyre.
- Organizimi dhe realizimi i ditëve të informimit me maturanët, në lidhje me programet e studimit të ofruara nga institucioni për vitin akademik 2020-2021.
- Nxitja dhe mbështetja e personelit akademik për kualifikim në të gjitha nivelet dhe drejtimet.
- Pjesëmarrja në veprimtari shkencore, në procese kërkimi dhe botimi brenda dhe jashtë vendit.

Veprimtaria mësimore e mbështetur nga aktiviteti kërkimor shkencor i personelit akademik dhe kualifikimin e tij në vijimësi, e ka vendosur universitetin në nivele gjithëpërfshirëse për zhvillimin e arsimit dhe veprimtarisë kërkimore studimore, për rajonin dhe më gjërë.

Risi në drejtim të përmirësimit të mësimdhënies, kanë sjellë studimet e ndryshme të konkretizuara përmes artikujve, kumesave, referateve etj.

Gjatë vitit akademik 2020-2021, veprimtaria mësimore e universitetit në tërësi është karakterizuar nga përpjekje intensive e të vazhdueshme të personelit akademik për të instaluar metoda e forma bashkëkohore për transmetimin dhe përjetësimin e dijeve në mënyrë që studentët të zhvillojnë ato shprehje e kompetenca që u duhen për të ardhmen.

Të dhënat janë nga monitorimet e strukturave drejtuese të universitetit, si dhe bazuar në raportet e analizave të realizuara në nivel njësie bazë dhe kryesore.



Lidhur me mbarëvajtjen e procesit mësimor, vlerësohet kapaciteti intelektual e profesional i personelit akademik, përgatitja për orën e mësimi, niveli i përgatitjes së studentëve dhe përgatitja e tyre sistematike dhe e vazhdueshme, nga baza materiale e didaktike, kushtet e mjedistit mësimor etj. Nga ana e personelit akademik në përgjithësi ka pasur angazhim serioz në procesin e mësimdhënies, por në disa raste të veçanta janë vërejtur edhe probleme, prandaj është tërhequr vëmendja në funksion të përmirësimit të situatës.

Bisedat me personelin akademik dhe studentët, kontrollet, vëzhgimet, kontrolli i dokumentacionit etj., në vijimësi kanë mundësuar ecurinë normale të këtij procesi, si në aspektin sasior (realizimin e orëve të programit) ashtu edhe në aspektin cilësor. Në vijimësi është bërë ballafaqimi i planeve kalendare me orët e realizuara nga personeli akademik, si dhe janë hartuar planet për plotësimin e orëve të parealizuara për arsye të ndryshme (raportet mjekësore, festa zyrtare etj), para përfundimit të çdo semestri.

Gjatë vitit 2020-2021, në zhvillimin e procesit mësimor janë vërejtur elementë të përdorimit të metodave dhe formave bashkëkohore të mësimdhënies si gjatë leksioneve, ashtu edhe gjatë seminareve dhe praktikave laboratorike, për pajisjen e studentëve me shprehje të përgjithshme dhe të transfereuese, duke synuar:

- Të bëhet përcaktimi i objektivave për procesin e mësimdhënies e mësimnxënies.
- Në procesin mësimor të kihet parasysh trija e rolit të studentit duke e shndërruar atë nga një subjekt pasiv në aktiv, kërkuës dhe pjesëmarrës, pra të realizohet një mësimdhënie ndërvepruese e fokusuar te studenti.
- Studentët të angazhohen në veprimtari kërkimore dhe krijuese.
- Përfshirja e studentëve të viti të fundit të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë në kryerjen e mikrotezave.
- Të aplikohen metoda më rezultative për kontrollin e dijeve.

Gjatë periudhës mars-korrik 2021 janë zhvilluar takime informuese mbi projektin CleanScore në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani". Ato u prezantuan me :

- Korrigjimin e automatizuar të provimeve.
- Përkthimin e teksteve akademike ndërkombëtare në fushën e ekonomisë dhe edukimit.
- Zhvillimi i provimeve me anë të projektit CleanScore.

Gjatë sezonit veror të provimeve u zhvilluan disa provime me anë të komponentit të korrigjimit të automatizuar të provimeve, ku pedagogët që zhvilluan provimet shprehën vlerësimet maksimale mbi implementimin e projektit në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani". Në total janë zhvilluar 9 provime në auditor me anë të korrigjimit të automatizuar të provimeve në Fakultetin Ekonomik.

Janë bërë përpjekje në vijimësi për plotësimin e kërkesave të departamenteve për bazë materiale si nga ana sasiore ashtu edhe cilësore.

Rezultate pozitive ka dhënë edhe vlerësimi i vazhduar gjithëvjetor i studentëve, i cili merret parasysh sipas një përqindje të caktuar në vlerësimin përfundimtar të tyre.

Në drejtim të trijës së cilësise të procesit mësimor dhe trijës së nivelit mësimor e shkencor në të gjitha programet e studimit të universitetit, një rol të rëndësishëm kanë luajtur investimet duke plotësuar të gjitha nevojat.

Në disa programe studimi, nga ana e studentëve, ka një pjesëmarrje më të kënaqshme se 2021 e kaluara në leksione, por përpjekjet për përgatitjen e seminareve, punëve praktikë dhe



Për FSHN praktikat profesionale për programin e studimit bachelor dhe master "Teknologji e informacionit", për programet e studimit me karakter profesional, praktikat në terren (ekspeditat) në programin e studimit "Biologji kimi" dhe master, janë zhvilluar sipas programeve mësimore përkatëse dhe viteve të studimit.

T'i kushtohet më tepër kujdes marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave profesionale në institucionet e administratës publike në rajon si dhe në subjektet e ndryshme private.

Studentët janë pajisur me udhëzuesit dhe bazën materiale përkatëse për zhvillim sa më cilësor të këtyre praktikave.

Vlerësimi i studentëve është kryer duke kombinuar vlerësimin e njohurive teorike dhe atyre praktike.

#### *Praktika mësimore profesionale dhe në terren në Fakultetin e Shkencave Humane*

Një problematikë ishte pamundësia për të realizuar në institucione praktikën mësimore për programin e studimit "Diplomë profesionale në sekretarë të specializuar dhe administrativë" dhe ekspeditën mësimore të vitit të tretë në programin e studimit "Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi".

Për ekspeditën, problemi u zgjidh duke u shpërndarë studentëve pyetësorë për t'i plotësuar në vendet ku jetonin dhe t'i dorëzonin ato elektronikisht.

Për praktikën e programit "Diplomë profesionale në sekretarë të specializuar dhe administrativë", përjekja jonë për të lidhur marrëveshje bashkëpunimi me ZVA Elbasan, për shkakë burokratike nuk u krye në kohën e duhur.

Praktikat e programeve të studimit "Bachelor në gazetari", "Bachelor në gazetari anglisht" dhe master profesional në "Gazetar reporter", u bë e mundur që të zhvillohen gjatë periudhës trijavore të konsultimeve në muajin qershor.

Kryesisht, studentët u shpërndanë në media lokale të qytetit të Elbasanit dhe disa prej mediave kombëtare në Tiranë.

Gjithashtu u pranuan edhe praktikat vullnetare të studentëve në qytetet e tyre.

#### *Praktika mësimore profesionale në Fakultetin Ekonomik*

Për FE praktikat profesionale janë kryer në institucionet e administratës publike në rajon si dhe subjektet e ndryshme private. Studentët janë njohur me organizimin e njësive ekonomike konkrete, me dokumentacionin bazë kontabël, me sistemin e kontabilitetit që ata zbatojnë dhe organizimin e tij, informatizimin e kontabilitetit, përgatitjen dhe publikimin e pasqyrave financiare, me regjistrimin e tyre, me marrëdhëniet me organet tatimore etj.

Zhvillimi i praktikave profesionale u ka dhënë mundësi studentëve të vëzhgojnë dhe të ushtrohen në pozicione të ndryshme pranë administratës publike, të njohin mënyrën e organizimit të institucioneve publike, bazën ligjore ku mbështesin veprimtarinë, marrëdhëniet e bashkëpunimit dhe të varësisë ndërmjet tyre, mënyrën e përdorimit të fondeve publike, përgjegjësinë në rast të shkeljeve të legjislationit etj.

Praktikat profesionale u krijojnë mundësi studentëve për të zbatuar në praktikë njohuritë e marra dhe për t'i aftësuar në tregun e punës.

Vazhdon të mbetet problem realizimi i praktikave mësimore të programit të studimit "Administrim biznes dhe inxhinieri" si dhe "Ekonomi turizmi", sidomos në bashkëpunimi është realizuar online.



Përshtatja me udhëzimet apo aktet e reja nënligjore, vijon të ngelet si detyrë që problematikat dhe përmirësimet në aspektin e mësimdhënies të pasqyrohen në rregulloren e universitetit dhe të programeve të studimit.

Numri i studentëve të regjistruar sipas programeve të ndryshme të studimit, padyshim ka ndikimin e vet për organizimin dhe realizimin e procesit mësimor.

Për vitin akademik 2020-2021 është krijuar tabloja e studentëve, që ndjekin studimet në vitet e para, në të gjitha programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë me kohë të plotë dhe informacionet përkatëse janë në tabelat e mëposhtme për çdo fakultet (sipas pikës j të udhëzimit nr. 5 dt. 19.02.2018).

Në universitetin tonë numri i përgjithshëm i studentëve të rinj që ndjekin studimet në vitet e para për vitin akademik 2020-2021, në të gjitha programet dhe format e studimit, është **2498** studentë si më poshtë:

- Regjistrime të reja në programe studimi me karakter profesional dhe bachelor, 1561 studentë.
- Regjistrime të reja në programe studimi master profesional, 534 studentë.
- Regjistrime të reja në programe studimi master i shkencave, 403 studentë.

Edhe për këtë vit akademik nisur nga vlerësimi i shifrave mbi regjistrimet në vitet e para për programet e studimit me kohë të plotë, vihen re dukuritë e mëposhtme:

*Së pari*, vijon të jetë në rënie numri i studentëve krahësuar me regjistrimin e studentëve të ciklit të parë në raport me vitin paraardhës, sidomos në programet e studimit me orientim mësimor.

Ndërkohë, disa programe studimi në këtë vit akademik kanë qenë joaktive:

1. Bachelor në gjuhë shqipe dhe rome.
2. Bachelor në fizikë kompjuterike.
3. Master profesional në gazetari sportive.
4. Master profesional gazetar reporter.
5. Master profesional në redaktim.
6. Master profesional në analist prodhimi.
7. Master i shkencave në studime letrare.
8. Master i shkencave në studime gjeografike.
9. Master i shkencave në trashëgimi kulturore.

*Së dyti*, për cilësinë është tregues nota mesatare e shkollës së mesme e studentëve të regjistruar në vitet e para në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të plotë. Për vitin akademik 2020-2021 vihet re në tërësi një përmirësim i rritjes së cilësive të studentëve të regjistruar në ciklin e parë të studimeve, e ndikuar kjo edhe nga vendimi përkatës i Këshillit të Ministrave, i cili përcakton vendosjen e notës mesatare mbi 6,5 dhe 7,5 të pranimit të maturantëve në universitet.

*Së treti*, për Universitetin e Elbasanit është ruajtur hapësira gjeografike e rajoneve nga vijnë studentët, ku mund të përmendim Elbasanin, Librazhdin, Gramshin, Peqinin, Lushnjën, Kavajën, Pogradecin, Tiranën, Fierin, Kukësin, Peshkopinë etj.



Pjesëmarrje në takime online:

- U organizua takimi online *Erasmus Going Digital Thessaloniki 2020* në datën 05.11.2020 ndërmjet UE dhe Aristotle University of Thessaloniki.
- U organizua takimi online *International Staff week* në datat 01.03.2021/05.03.2021 ndërmjet UE dhe University of Pitești.
- U organizua takimi online *Erasmus staff week* në datat 26.05.2021/27.05.2021 ndërmjet UE dhe Lithuania Business University of Applied Sciences.
- U organizua takimi online *Erasmus + Meeting* në datën 02.06.2021 ndërmjet UE dhe Cracow University Of Economics.
- Përgatitja e pyetësorëve *Quality Questions* të dërguar nga universitetet partnere për t'u informuar për të dhënat e përgjithshme për Universitetin e Elbasanit "Aleksander Xhuvani" për vitin akademik 2020-2021. Këto pyetësorë na kanë ardhur nga universitetet partnere me të cilët kemi bashkëpunime, por edhe nga universitete të tjera me të cilët kemi shkëmbyer kërkesa për të lidhur marrëveshje të reja.
- Përgatitja e *Inter-Institutional Agreement* të dërguar nga universitetet partnere për vitin akademik 2020-2021. Inter-Institutional Agreement na kanë ardhur nga universitetet partnere me të cilët kemi bashkëpunime, por edhe nga universitete të tjera me të cilët kemi shkëmbyer kërkesa për të lidhur marrëveshje të reja.

Për vitin akademik 2020-2021 janë realizuar mobilitetet për stafin akademik:

- mobilitete incoming (hyrëse) nga universitetet partnere.
- mobilitete outgoing (dalëse) nga UE drejt universiteteve partnere.

**Tabela me emrat e stafit që kanë qenë në mobilitete me Erasmus+ për vitin akademik 2020-2021**

| Nr. | Emër Mbiemër     | Fakulteti | Universiteti pritës                    |
|-----|------------------|-----------|----------------------------------------|
| 1   | Fatos Gjata      | FSHH      | University of Veliko Tarnovo, Bullgari |
| 2   | Eda Çela         | REKTORAT  | University of Veliko Tarnovo, Bullgari |
| 3   | Filip Qosja      | REKTORAT  | University of Veliko Tarnovo, Bullgari |
| 4   | Edmond Biçoku    | FSHE      | University of Veliko Tarnovo, Bullgari |
| 5   | Skender Topi     | REKTORAT  | University of Veliko Tarnovo, Bullgari |
| 6   | Hysen Domi       | FSHE      | University of Veliko Tarnovo, Bullgari |
| 7   | Arian Hyka       | FSHE      | University of Veliko Tarnovo, Bullgari |
| 8   | Ervis Sanço      | REKTORAT  | Cracow University Of Economics, Poloni |
| 9   | Artan Teri       | REKTORAT  | Cracow University Of Economics, Poloni |
| 10  | Eda Çela         | REKTORAT  | Istanbul Technical University, Turqi   |
| 11  | Skender Topi     | REKTORAT  | IES, Ribiera do Louro, Spanjë          |
| 12  | Elvira Fetahu    | FE        | IES, Ribiera do Louro, Spanjë          |
| 13  | Altin Idrizi     | FE        | IES, Ribiera do Louro, Spanjë          |
| 14  | Mimoza Kotollaku | FE        | IES, Ribiera do Louro, Spanjë          |
| 15  | Marsida Kënuti   | FE        | IES, Ribiera do Louro, Spanjë          |
| 16  | Valbona Ballkoci | FE        | IES, Ribiera do Louro, Spanjë          |
| 17  | Suela Hajdari    | FE        | IES, Ribiera do Louro, Spanjë          |

|    |                                                                |                                                                                                                                   |                                                                                                                                     |              |            |
|----|----------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------|------------|
| 2. | Erasmus +<br>2019-1-AL-<br>EPPKA2-CBHE                         | BKStone-<br>platform for fostering,<br>modernization and<br>sustainable growth in<br>natural stone industry in<br>Western Balkans | Enterprise<br>platform for fostering,<br>modernization and<br>sustainable growth in<br>natural stone industry in<br>Western Balkans | Altin Idrizi | 60.005 EUR |
| 3. | Erasmus +<br>617886-EPP-1-<br>2020-1-FI-<br>EPPKA2-CBHE-<br>SP | EntrAL<br>Entrepreneurial skills for<br>a modern education in<br>Albania                                                          | Imelda<br>Sejdini                                                                                                                   | 62.000 EUR   |            |
| 4. | Erasmus +<br>620689-EPP-<br>1_2020-1AL-<br>EPPJMO-CHAIR        | ACHBIA-<br>communitaire: hardest<br>burden for integration of<br>Albania                                                          | Arbër Gjeta                                                                                                                         | 46.530 EUR   |            |

### Konfirmime diplomimi për ish studentë të UE-së

Gjatë vitit akademik 2020-2021 janë bërë 33 konfirmime diplomash, lista notash dhe plotësime formularësh të ish-studentëve të cilët kanë mbaruar studimet në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”. Këto konfirmime janë bërë sipas kërkesave nga kompani, universitete dhe institucione të shteteve të huaja, ku studentët e diplomuar në UE kanë aplikuar për arsye nga më të ndryshmet, si njohjen e diplomave, regjistrime për studime, regjistrime punësimi etj. Kërkesat më shumë janë nga SHBA, Britani e Madhe, Kanada dhe shumë shtete të tjera.

### Tabela me të dhënat e plota

| Nr. | Emër      | Mbiemër           | Data       | Shteti                                       |
|-----|-----------|-------------------|------------|----------------------------------------------|
| 1   | Borbardha | Ceriku            | 08.10.2020 | Cyny, New York, USA                          |
| 2   | Elda      | Gjoshe            | 19.10.2020 | NetForce Global LLC, USA                     |
| 3   | Alma      | Tarelli           | 19.10.2020 | Transcript Assessment Team, Kanada           |
| 4   | Adriatik  | Danzi             | 26.10.2020 | Costumer Service Team, Qatar                 |
| 5   | Lelo      | Tesho             | 26.10.2020 | Qualification Check Team, UK                 |
| 6   | Danjela   | Hidri             | 27.10.2020 | Hollandë                                     |
| 7   | Malvin    | Cfarku            | 29.10.2020 | Josef Slini & Associates Inc, USA            |
| 8   | Mirela    | Lloshi (Causbi)   | 27.11.2020 | HereRight, UK                                |
| 9   | Roxhensa  | Lipo              | 11.12.2020 | World Education Services, USA                |
| 10  | Klipton   | Hela              | 11.12.2020 | World Education Services, USA                |
| 11  | Delina    | Gjeli             | 18.12.2020 | HereRight, UK                                |
| 12  | Geri      | Bicoku            | 24.12.2020 | Nacid, Bullgari                              |
| 13  | Matilda   | Biqiku (Filipeu)  | 13.01.2021 | Ontario College of Teachers, Kanada          |
| 14  | Gledisa   | Muka              | 11.02.2021 | Data Flow Group, Dubai, Emiratet e Bashkuara |
| 15  | Sidorela  | Guzi (Muba)       | 01.03.2021 | CGFNS, USA                                   |
| 16  | Jakup     | Idrizi            | 06.04.2021 | Ministritë për Evropë dhe Punë të Jashtme    |
| 17  | Dorina    | Gramatko (Belliu) | 26.05.2021 | IntelMaster, UK                              |
| 18  | Juliana   | Bengu             | 07.06.2021 | ENIC-NARIC, Suedi                            |



|    |                                                          |                                                                                                                                                 |
|----|----------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 12 | University of Oviedo                                     | Research, study programs , training mobilities students and staff, double degree diploma.                                                       |
| 13 | Mnedel University in Brno                                | Student exchange agreement.                                                                                                                     |
| 14 | Josip Juraj Strossmayer University of Osijek, Croatia    | Fostering joint projects in the field of education and research.                                                                                |
| 15 | Constantin Brancusi University of Targu-Jiu, Romania     | Students and staff, joint research and educational projects.                                                                                    |
| 16 | Czech University of Life Sciences                        | Students and staff, joint research and educational projects.                                                                                    |
| 17 | University of National and World Economy                 | Students and staff, joint research and educational projects.                                                                                    |
| 18 | Northern Illinois University                             | Educational exchange.                                                                                                                           |
| 19 | International School Project                             | Cooperation in common research projects, study programmes, training mobilities students and staff.                                              |
| 20 | St. Cyril and St. Methodius University of Veliko Tarnovo | Students and staff exchange.                                                                                                                    |
| 21 | Kolegji Biznesi, Prishtinë                               | Shkëmbimin e studentëve dhe stafit, projekte të edukimit dhe kërkimore.                                                                         |
| 22 | Kolegji AAB, Prishtinë                                   | Shkëmbimin e studentëve dhe stafit, projekte të edukimit dhe kërkimore.                                                                         |
| 23 | Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini"                 | Shkëmbim të stafit, promovimin e seminareve, kurseve, konferencave, përgatitjen e projekteve kërkimore.                                         |
| 24 | Universiteti Euro-Balkan, Shkup                          | Bashkëpunim në fushën e kërkimit shkencor dhe mësindhëties.                                                                                     |
| 25 | Universiteti "Kadri Zeka", Gjilan                        | Shkëmbim të stafit dhe të studentëve për kërkime shkencore, promovimin e seminareve, kurseve, konferencave, përgatitjen e projekteve kërkimore. |

• Marrëveshje bashkëpunimi brenda vendit

| Nr. | Institucionet bashkëpunuese     | Marrëveshja e bashkëpunimit                                                                                                                                                                                             |
|-----|---------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1   | University of New York Tirana   | 1. The cooperation in common research projects. 2. The cooperation in study programmes.                                                                                                                                 |
| 2   | Universiteti European i Tiranës | 1. Bashkëpunim dhe bashkërendimin e aktivitetëve të palëve me synim komunikimin dhe shkëmbimin e personelit akademik, studentëve, informacioneve, ideve dhe eksperiencave që lidhen me fushat me interes të përbashkët. |
| 3   | Universiteti i Sporteve Tiranë  | Komunikimin dhe shkëmbimin e personelit akademik, studentëve, informacioneve, ideve dhe eksperiencave që lidhen me fushat me interes të përbashkët.                                                                     |
| 4   | Universiteti i Mjekësisë Tiranë | Shkëmbimin e personelit akademik për procesin mësimor, shkëmbimin e pedagogëve, të kërkuesve dhe të studentëve në kuadrin e veprimtarisë kërkimore shkencore. Shkëmbimin e përvojës lidhur me menaxhimin institucional. |
| 5   | Albanian University             | Zhvillimin e kapaciteteve të nevojshme në drejtimin e studimeve shkencore. Promoviminin e iniciativave shkencore dhe shkëmbimin kulturor.                                                                               |

|    |                                                        |                                                                                                                                                                                                                        |
|----|--------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 24 | Qendra e Testimit S.T.A                                | Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja, testeve ndërkombëtare për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë.                                        |
| 25 | University of Cambridge                                | Sigurimin e standardit gjatë procesit të testimit të gjuhës angleze, garantimin e certifikimit të rezultatit të arritur gjatë testimit.                                                                                |
| 26 | Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Elbasan                    | Për zhvillimin e praktikave mësimore.                                                                                                                                                                                  |
| 27 | Albanian-American Development Foundation               | Zbatimin e projektit CleanScore në përcaktimin e cilësisë së materialeve mësimore dhe vlerësimin e performancës së studentëve.                                                                                         |
| 29 | Drejtoria e përgjithshme e arkivave                    | Promovimin e arsimit të lartë, kërkimin shkencor, rrëtimin e kapaciteteve të personelit akademik dhe të studentëve.                                                                                                    |
| 30 | Qendra "Gratë në Shërbim Publik"                       | Shkëmbimin e informacionit reciprok, angazhimin ndërmjet palëve për nxijën e mundësive të reja veçanërisht të studentet vajza.                                                                                         |
| 31 | Prokuroria pranë Gjykatës së shkallës së parë, Elbasan | Për zhvillimin e praktikave mësimore.                                                                                                                                                                                  |
| 32 | Save The Children                                      | Promovimin e arsimit të lartë, kërkimin shkencor rrëtimin e personelit akademik dhe të studentëve.                                                                                                                     |
| 33 | Elite Travel Group                                     | Zhvillimin e nismave të aktivitetëve të përbashkëta.                                                                                                                                                                   |
| 34 | Drejtoria e kulturës kombëtare, Durrës                 | Bashkëpunimin dhe mbështetjen e studentëve në zhvillimin e praktikave mësimore në mjediset e këtij institucioni.                                                                                                       |
| 35 | Albanian Center For Quality Journalism                 | Lehtësimin e marrëdhënieve ndërinstitucionale për bashkëpunim e bashkërendimin e aktivitetëve të palëve me synim komunikimin dhe shkëmbimin e ideve, informacionit dhe eksperiencave.                                  |
| 36 | Save The Children                                      | Sfidat aktuale të studentëve lidhur me praktikat profesionale me fokus edukimin e fëmijëve nga pakicat etnike.                                                                                                         |
| 37 | Komisioni për mbrojtjen nga diskriminimi               | Promovimin e arsimit të lartë, kërkimin shkencor rrëtimin e kapacitetit të personelit akademik dhe studentëve.                                                                                                         |
| 38 | Qendra Balashe Bashkia, Elbasan                        | Kryerja e praktikave profesionale dhe aktivitetin kërkimor-shkencor pranë qendrës Balashe, Bashkia Elbasan.                                                                                                            |
| 39 | Internacional Virtual E-Hospital Foundation            | Ndërtimi dhe vendosja në funksionim e qendrës së teleinfermieristikës, ekselencës dhe njësisë së trajnit të urgjencës mjekësore.                                                                                       |
| 40 | Protek Innovatin Center                                | Zhvillimin e sektorit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.                                                                                                                                                |
| 41 | Kuvendi i Shqipërisë                                   | Institucionalizimi i marrëdhënieve për bashkëpunim dhe bashkërendimin e aktivitetëve të palëve me synim komunikimin dhe shkëmbimin e informacioneve, ideve dhe përvojave që lidhen me fushat me interes të përbashkët. |
| 42 | Autoriteti i Mbrojtjes Financiare                      | Zhvillimin dhe transmetimin e dijeve përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve nga institucionet e arsimit të lartë.                                                                                       |
| 43 | Kryqi i Kuq Shqiptar                                   | Realizimin e projektit të dhurimit vullnetar të gjakut.                                                                                                                                                                |

• Marrëveshje në kuadër të Mobiliteteve Erasmus+

| Nr. | Shteti | Nr. | Universiteti                                |
|-----|--------|-----|---------------------------------------------|
| 1   | Itali  | 1   | Politecnica delle Marche University, Ancona |
|     |        | 2   | Bologna University                          |



## **Veprimtari të tjera për vitin akademik 2020-2021**

Gjatë këtij viti veprimtaria është fokusuar në organizimin dhe bashkëorganizimin e aktiviteteve të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare, ku UE ka marrë pjesë sipas metodologjisë së pjesëmarrjes të imponuar nga situata e pandemisë së COVID-19.

- Pjesëmarrja e studentëve të programit të studimit "Bachelor në gazetari", në Festivalin e Filmave të Studentëve të Gazetarisë, projekt i mbështetur nga USAID. Në festival u shpallën dhe u vlerësuan filmat më të mirë të realizuar nga studentët e Universitetit të Elbasanit "Aleksander Xhuvani" dhe studentët e Universitetit "Luigj Gurakuqi" të Shkodrës. Filmi më i mirë: "Rini e ikun" (Shkodra). Filmi i zgjedhur nga publiku "Përshpërimë engjëjsh" (Elbasan). Filmi i për zgjedhur i ambasadorëve të SHBA dhe Mbretërisë së Bashkuar "Historia e Fjonës" (Shkodra). Vlerësime morën të gjithë për punën e shkëlqyer me montazhin, videon, audion, personazhin më të mirë.
- Studentët e UE-së, morën pjesë në sesionet informuese për votuesit e rinj që do të organizohen nga Këshillat Amerikanë për Arsimin Ndërkombëtar dhe KRIIK, me mbështetjen financiare të Ambasadës amerikane.
- Në 03.05.2021, në kuadër të projektit për ngritjen e kapaciteteve e VIVA (Enhancing and Validating service related competences in versatile learning environments in Western Balkan Universities), organizohet në Universitetin e Elbasanit "Aleksander Xhuvani", "Workshop për validimin e kompetencave në fushën e shërbimeve". Ky aktivitet pati si qëllim, që në një tryezë të përbashkët me pjesëmarrjen e bizneseve, të diskutojë mbi nevojat dhe domosdoshmëritë e kompetencave në shërbime, sidomos referuar kurrikulave universitare dhe subjekteve të biznesit në Dardun e Elbasanit.
- Në 02.06.2021, u organizua në Universitetin e Elbasanit, për të dytën vit radhazi, programi "Klubi i Debatit". Ky program realizohet në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit mes UE dhe Junior Achievement Albania, i financuar nga Fondi Amerikan i Zhvillimit.
- Në 07.06.2021, organizohet leksioni i hapur: Prokurimet publike në Shqipëri në kuadër të përafrimit me Direktivën e BE. Roli i GJED në fushën e prokurimeve.
- Në 02.06.2021, Rektorati i Universitetit të Elbasanit, "Aleksander Xhuvani" i dha certifikatë mirënjohje studentit Sadush Gëzim Tosuni me motivacionin "Për shpalljen kampion universitar mbarekombëtar në ping pong".
- Në gusht 2021, studentët e programit "Operator turistik në gjuhë gjermane", zhvillojnë seancë trajnimi me profesorë të Humboldt-Universitätt zu Berlin. Profesorë të Fakultetit të Shkencave Humane dhe Sociale të Humboldt-Universitätt zu Berlin, Gjermani, trajnuan për dy ditë, studentët e programit të studimit. Profesorët në Universitetin e Elbasanit "Aleksander Xhuvani" gjetën një klimë bashkëpunuese dhe studentë të përgatitur e mjaft kërkuar.

revistave, librave, burimeve primare, artefaktet, ekzemplarët dhe dokumente në koleksione.

- Gjatë këtij viti akademik është aplikuar për projekte kërkimi shkencor të financuar nga AKKSHI, si vijon:

| <b>Nr.</b> | <b>Titulli i projektit</b>                                                                                                       | <b>Propozuesi</b>    | <b>Buxheti, kërkuar nga AKKSHI</b> |
|------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------|------------------------------------|
| 1          | Oferta aktuale akademike përkundër kërkesave të bizneseve mbi aftësitë dhe kompetencat e burimeve njërezore.                     | Elvira Fetahu (FE)   | 985,000 ALL                        |
| 2          | Hulumtimi i ndryshimit të modeleve të punësimit (fuqisë punëtore) gjatë dhe pas pandemisë së COVID 19 në qarkun Elbasan          | Imelda Sejdimi (FE)  | 1,932,800 ALL                      |
| 3          | Veprat penale lidhur me Covid-19                                                                                                 | Rezarta Tahiri (FE)  | 1,694,000 lekë                     |
| 4          | Një vlerësim numerik i bashkëjetesës fetare dhe veprimtarisë së komuniteteve fetare në biznes: Rasti studimor i Shqipërisë       | Ardita Todri (FE)    | 1,832,000 Lekë                     |
| 5          | Shkolla verore për përgatitjen profesionale të mësuesve në aspektin e përmbytjes shkencore                                       | Teuta Toska (FSHH)   | 928,791 ALL                        |
| 6          | Mësimdhënia në periudhë pandemie. Zhvillimi i kapaciteteve studentore gjatë një procesi arsimor të alternuar fizik e në distancë | Lenida Lekli (FSHH)  | 1,264,000 ALL                      |
| 7          | Ndikimi i COVID-19 në organizimin dhe menaxhimin e sistemit shëndetësor, implementimi i një modeli epidemiologjik-matematicor    | Elona Gaxhja (FSHMT) | 1,790,000 ALL                      |

**Ndërkohë, janë shpallur fitues këto projekte:**

| <b>Nr.</b> | <b>Titulli i projektit</b>                                                                                                                                          | <b>Propozuesi</b>    | <b>Buxheti i financuar nga AKKSHI</b> |
|------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------|---------------------------------------|
| 1          | Oferta aktuale akademike përkundër kërkesave të bizneseve mbi aftësitë dhe kompetencat e burimeve njërezore.                                                        | Elvira Fetahu (FE)   | 985,000 ALL                           |
| 2          | Hulumtimi i ndryshimit të modeleve të punësimit (fuqisë punëtore) gjatë dhe pas pandemisë së COVID 19 në qarkun Elbasan                                             | Imelda Sejdimi (FE)  | 1,932,800 ALL                         |
| 3          | Mësimdhënia në periudhë pandemie: Zhvillimi i kapaciteteve studentore (Cikli i dytë i studimeve, Master) gjatë një procesi arsimor të alternuar fizik e në distancë | Lenida Lekli (FSHH)  | 1,264,000 ALL                         |
| 4          | Ndikimi i COVID-19 në organizimin dhe menaxhimin e sistemit shëndetësor, implementimi i një modeli epidemiologjik-matematicor                                       | Elona Gaxhja (FSHMT) | 1,790,000 ALL                         |





UE kontribuon në përfshirjen e personelit akademik të Universitetit në projekte ndëruniversitare apo institucionale. Në kuadër të zbatimit të projektit TEAVET "Developing teacher competencies for a comprehensive vet system in Albania", ka vazhduar trajnime të mësuave. Trajnimet janë zhvilluar në Qendrën e të Mësuarit Gjatë Gjithë Jetës (Long Life Learning Center), qender kjo e krijuar në kuadër të projektit. Tema e trajnimit e realizuar në vitin akademik 2020-2021 ishte : "Mësimdhënia e kombinuar me sistemet e menaxhimit të të nxënit". Gjithsej në këtë trajnim kanë rritur njohuritë rreth 20 mësues të Ciklit të Arsimit të Mesëm të Ujtë dhe Ciklit të Arsimit të Mesëm të Lartë.

Qelimi i këtij projekti është zhvillimi i ekspertizës akademike përmes krijimit të qendrave të specializuara në universitetet shqiptare dhe shpërndarjes së programeve të trajnimit standard me cilësi të lartë në fushën e zhvillimit të kompetencave profesionale gjatë gjithë jetës në Shqipëri.

Lidhur me kërkimin shkencor, UE për çdo vit akademik ka parasysh dhe e orienton veprimtarinë e vet në disa drejtime:

- Të identifikojë objektivat e kërkimit shkencor, fushat prioritare në bashkërendim me politikat sektoriale të zhvillimit si dhe Programet Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit (në fushat e shkencave natyrore, teknologjike, mjekësore, bujqësore, sociale dhe humane) të cilat, zbatohen nëpërmjet projekteve të kërkimit dhe zhvillimit teknologjik. Ky prioritet është në funksion të arritjes së objektivave të caktuara në kërkimin shkencor dhe zhvillimin teknologjik me rëndësi për përpimin ekonomik, shoqëror dhe kulturor të rajonit dhe vendit.
- Hartimi i një kalendari vjetor të aktiviteteve shkencore-kulturore (konferenca kombëtare e ndërkombëtare, seminare, simpoziume, lektoriune, leksione të hapura, referime shkencore etj).
- Vënia e veprimtarisë kërkimore shkencore të universitetit në funksion të rritjes së cilësisë së procesit të arsimit dhe zhvillimit të vazhdueshëm.
- Të realizojë vlerësimin e veprimtarisë kërkimore shkencore të njërive bazë dhe krijimi i një komuniteti akademik (në nivel departamenti, fakulteti e më gjerë).
- Integrimi real i mësimdhënies me kërkimin shkencor duke e konsideruar këtë si domosdoshmëri për të përballuar sfidat e shkollimit universitar.
- Rritja e fondit (buxhetit) në favor të kërkimit.
- Vazhdimi me ritme të shpejta i kualifikimit të personelit akademik.
- Përfshirje më e gjerë në projektet kërkimore-shkencore kombëtare e ndërkombëtare.
- Nxitja e një gjenerate të re kërkuesish shkencorë në fushat e politikave sociale, mjedisore dhe ekonomike.
- Vendosje të kërkimit në funksion të komunitetit, mjedisit e shoqërisë në tërësi.
- Rritja e cilësisë dhe e numrit të botimeve të përgatitura nga anëtarët e departamenteve (artikuj, monografi, tekste mësimore etj.).
- Zgjerimi dhe forcimi i marrëdhënieve të partneritetit me institucionet vendore arsimore (Drejtori Arsimore, shkolla etj.), bankat, spitalin, bizneset e qarkut, institucione kërkimore-shkencore, trajnuese, botuese etj.
- Zgjerimi i kapacitetit të bibliotekës.
- Botimi i të paktën dy organeve shkencore (periodikë) të UE-së.
- Angazhimi për të siguruar lidhjet ndërkombëtare, sidomos me universitetet evropiane për të aplikuar në projekte të përbashkëta për ngritje kapacitetesh.



- Hartimi i planeve dhe programeve të reja mësimore.
- Përmirësimi i planeve dhe programeve ekzistuese, duke angazhuar të gjithë personelin akademik të departamenteve, për përmirësimin dhe ristikurimin e planeve dhe programeve mësimore.
- Zhvillimi i kurikulave, planeve mësimore, cikleve të ligjëratave, konform udhëzimeve dhe Ligjit të Arsimit të Lartë.
- Forcimi i punës kërkimore-shkencore, me qëllim arritjen e objektivave profesionale dhe atyre të kualifikimit shkencor të personelit akademik.
- Pjesëmarrja në veprimtari jashtëuniversitare të lidhura jo vetëm me performancën arsimore.
- Përditësimin dhe pasurimin e përmbajtjes së programeve mësimore dhe ligjëratave më të reja bashkëkohore të shkencës.
- Përdorimin e metodave dhe teknologjive më të reja në mësimdhënie.
- Hartimi dhe përgatitja e teksteve universitare dhe materialeve mësimore.
- Përgatitja e shkurtuar e disa programeve mësimore në dy gjatë.
- Vazhdimi i prezantimit të ciklive të leksioneve në trajtën e skripteve.
- Ekspedita për hulumtime dhe grumbullim materiali kërkimor dhe zhvillim analizash laboratorike.

Veprimtaria kërkimore realizohet nga personeli akademik në njësitë bazë apo grupet me karakter kërkimor-shkencor në dy kategori:

- a. kërkime shkencore bazë pa përdorim të menjëhershëm praktik;
